

## RAPORT PERIODIK Nr. 2

16 – 23 maj

27 maj 2011

### I. PËRMBLEDHJE

- Përpos disa vonesave nga ana e Komisioni Shtetëror Zgjedhor (KSHZ), përgatitjet për fushatën në përgjithësi janë të përpikta.
- KSHZ-ja ka funksionuar në mënyrë transparente, por duhet ende bërë që të arrijë një stil konsenzual gjatë trajtimit të disa çështjeve kundërshtuese.
- Komisionet komunale zgjedhore (KKZ) në përgjithësi janë të pëgatitura për zgjedhjet. Megjithatë, të gjithë janë ankuar se KSHZ-ja nuk ua ka transferuar fondet, gjë e cila ka rezultuar në atë që disa kryesues të KKZ-ve ti përdorin fondet e tyre vetanake për ta përkrahur funksionimin e KKZ-ës.
- Në vijim është trajnimi i komisioneve të rangjeve më të ulta. Edhe pse KSHZ-ja ka botuar manuale të cilat japin udhëzime për KKZ-ët dhe KZ-ët, ende mungon rregullacioni ligjor lidhur me këtë.
- Fushata zyrtarisht filloi më 16 maj dhe deri tani është zhvilluar me një intenzitet të ulët, në veçanti jashtë Shkupit. Retorika e vrazhdë e vërejtur gjatë periudhës përpara fillimit zyrtarë të fushatës përsëri është prezente.
- Fushata parimisht zhvillohet përmes mitingjeve të organizuara nëpër gjithë vendin. Vetëm një numër i vogël i partive përdorin billborde dhe postera, përderisa garuesit e tjerë përdorin aktivitete më të vogla dhe zbatojnë fushatën "prej dere në derë". Kjo parçialisht është kështu për shkak të mungesës së resurseve financiare.
- Edhe pse mediat deri tani ju kanë mundësuar votuesve transmetim të gjërë të fushatës, raportet preliminare të vëzhgimit të mediave të MVZ nga OSBE/ODIHR tregojnë se shumica e radiodifuzerëve ndjekin politika editoriale partiake.
- Deri tani vetëm një ankesë formale është dorëzuar në KSHZ edhe atë lidhur me fushatën e hershme. Shumica e garuesve kanë përcjellë ankesa verbale, në vend të dorëzimit të ankesave të shkruara formale. MVZ i OSBE/ODIHR vazhdon që ti ndjekë pohimet e më hershme lidhur me presionin mbi nëpunësit shtetëror për ti përkrahur partitë në pushtet gjatë zgjedhjeve.

## II. ADMINISTRATA ZGJEDHORE

Përpos vonesave për ti plotësuar disa afate zgjedhore, përgatitjet për zgjedhjet në përgjithësi janë të përpikta.<sup>1</sup> KSHZ vazhdon që të funksionojë në mënyrë transparente. Kolegialiteti dhe konsenzusi varen nga çështjet të cilat diskutohen dhe nga ajo se nëse mediat janë prezente. Votimi për çështjet senzitive politike ka qenë rreptësisht sipas linjave partiake.<sup>2</sup>

KSHZ ka miratuar dhe ka botuar dy manuale për trajnim, një për KKZ-ët dhe një tjetër për KZ-ët. KSHZ e informoi MVZ të OSBE/ODIHR se ato kanë për qëllim që ti miratojnë të gjitha ushëzimet procedurale të zgjedhjeve presidenciale dhe lokale të vitit 2009, të cilat do të vlejnjë për këto zgjedhje. Megjithatë, deri më sot kjo nuk është realizuar dhe manualët shërbejnë si zëvendësim për udhëzimin e punës së KKZ-ve dhe KZ-ve. Në vijim është trajnimi i detyrueshëm për KZ-ët.

KSHZ duhet të sjellë vendim për dizajnin e letrës votuese dhe numrin e fletave votuese të cilat duhet të shtypen dhe t'ju dorëzohen KKZ-ve.

Vëzhguesit e MVZ të OSBE/ODIHR raportojnë se KKZ-ët në përgjithësi janë të përgatitura për zgjedhjet. Megjithatë të gjitha KKZ-ët janë ankuar se nga ana e KSHZ-ës nuk u janë transferuar kurrëfar fonde.<sup>3</sup> Kjo ka rezultuar që disa kryesues të KKZ-ve ti përdorin fondet e tyre vetanake për ta përkrahur punën e KKZ-ës.

KSHZ deri më 24 maj planifikon që të inicojë një fushatë për edukimin e votuesve, e cila do të përfshijë tre video spote të cilat do të fokusohen në tre fusha kryesore: procedurat votuese, parregullësi gjatë ditës zgjedhore, si dhe apel për të votuar.

## III. ATMOSFERA E FUSHATËS ZGJEDHORE

Fushata zyrtarisht filloi më 16 maj në qetësi, mirëpo e përndjekur nga një nivel i lartë i mosbesimit mes partive kryesore të dy koalicioneve, të udhëhequra nga Organizata e Breshme Revolucionare Maqedone – Partia Demokratike e Bashkimit Kombëtar Maqedonas (VMRO-DPMNE) dhe Lidhja Social Demokrate e Maqedonisë (LSDM). Fushata deri tani është bërë përmes mitingjeve në vende të ndryshme në shtet,<sup>4</sup> por në përgjithësi ka qenë me intenzitet më të ulët, posaçërisht jashtë Shkupit. Në shumicë, vetëm VMRO-DPMNE përdor billborde dhe postera. Garuesit e tjerë kanë thënë se nuk do të përdorin billborde dhe postera dhe do të mbështeten në aktivitete të vogla dhe në fushatën "prej dere në derë", kryesisht për shkak të mungesës së resurseve financiare.<sup>5</sup>

Edhe pse partitë në përgjithësi kanë pasur liri për të organizuar mitingje, ka pasur disa raste të izoluara ku nuk ju është dhënë leje për shfrytëzimin e vendeve publike. Në disa komuna partitë kanë aplikuar për leje për të organizuar takime publike në zyrën e kryetarit të komunës edhe përpos të asaj që Kodi zgjedhor parasheh vetëm njoftimin e njësisë lokale të Ministrisë për punë

<sup>1</sup> Sa u takon afateve në kalendarin e KSHZ-ës, kanë ndodhur vonesat e ardhshme: trajnimi i obligueshëm për KKZ-ët filloi më 4 maj dhe jo 22 prill; vendim për krijimin e komisioneve zgjedhore jashtë vendit u soll më 15 maj dhe jo 3 maj; zëvendësimet në KKZ dhe KZ ende vazhdojnë edhe pse afati për ndryshime ishte 6 maj.

<sup>2</sup> Për shembull, më 16 maj, KSHZ votoi sipas interesave partiake dhe solli vendim që mos ta hetojë frikësimin e pohuar të votuesve i cili u publikuar nga *televizioni A1*.

<sup>3</sup> Nga 78 KKZ të kontaktuar nga Vëzhguesit afatgjatë (VAGJ) të OSBE/ODIHR, 77 nuk kanë marrë kurrëfar fonde nga KSHZ-ja.

<sup>4</sup> MVZ i OSBE/ODIHR në periudhën raportuese ka vëzhguar 23 mitingje dhe atë në Veles, Tetovë, Gostivar, Ohër, Kumanovë dhe komunat e Shkupit.

<sup>5</sup> Për shembull, LSDM-ja shpalli se ka marrë kredi mbi pronën e saj me qëllim që ta financojë fushatën e saj.

të brenshme (MPB).<sup>6</sup> Më 19 maj, kryetari i Komunës së Qendrës në Shkup e rrefuzoi organizimin e mitingut të cilin LSDM-ja e planifikonte për ta mbajtur në qendër të qytetit duke u arsyetuar se parku publik mund të dëmtohet. Më tej, kryetari e ka informuar me shkrim partinë se të vetmet mitingje të cilat do të autorizohen, do të jenë ato të cilat do të organizohen përpara zyrave të partive politike.

Rregullat e Kodit zgjedhor të cilat parashohin që komunat të përcaktojnë vende falas për vendosjen e materialeve të fushatës, janë zbatuar pa konsistencë. Përderisa disa komuna i kanë përcaktuar këto vende, të tjerat nuk e kanë bërë këtë.<sup>7</sup> Në disa komuna vendi falas është shpërndarë sipas marrëveshjes paraprake mes partive politike.<sup>8</sup>

Edhe pse shumica e liderëve të partive politike kanë shpallur se kanë për qëllim që të bëjnë fushatë pozitive, retorika e ashpër e cila u vërejt në periudhën përpara fushatës përsëri është prezente, parimisht mes VMRO-DPMNE-së dhe LSDM-ës. MVZ i OSBE/ODIHR gjithashtu ka vërejtur se folësit e Bashkimit Demokratik Shqiptar (BDSH) në Tetovë dhe lideri i Partisë Demokratike Shqiptare, Z. Menduh Thaci në Debreshtë, në komunën e Dollnenit, kanë përdorur fjalor nxitës për ta sulmuar qeverinë aktuale.

Disa parti e kanë ngritur çështjen e roleve të turbullta mes aktiviteteve qeveritare dhe ato të partive politike. MVZ i OSBE/ODIHR vazhdon që ti ndjekë pohimet e më hershme për presionin mbi nëpunësit shtetëror për ti përkrahur partitë në pushtet gjatë zgjedhjeve.<sup>9</sup>

Më 19 maj, kryeministri Nikolla Gruevski ka dërguar letër të hapur duke reaguar ndaj pohimeve gjërësisht të shpërndara për presion mbi të punësuarit në administratën shtetërore. Në letër ai kërkon nga të gjithë punonjësit publik ta garantojnë lirinë e zgjedhjeve dhe ka thënë se të gjithë ato të cilët do të përpiqen që të bëjnë presion mbi të punësuarit e tyre do të sanksionohen, pavarësisht nga përkatësia e tyre politike.

#### IV. MEDIA

Përderisa mediat deri tani ju kanë mundësuar votuesve një transmetim të gjërë të fushatës, shumica e transmetuesve të vëzhguar nga MVZ i OSBE/ODIHR përdorin politika editoriale partiake. Mandej ka munguar analiza dhe vlerësimi kritik, si dhe mbështetja e komenteve me fakte.

Në periudhën përpara fillimit zyrtar të fushatës dhe që prej atëherë, TV kanalet publike *MTV-1* dhe *MTV-2*, si dhe kanalet private *Sitel* dhe në një masë më të vogël *Kanal 5*, i kanë prezantuar kandidatët të cilët mbajnë poste si zyrtarë shtetëror në raste kur kanë bërë fushatë, duke dështuar që të bëjnë dallim mes roleve të tyre si kandidatë dhe zyrtarë shtetërorë.<sup>10</sup>

Transmetuesi publik i ka respektuar detyrat ligjore për të alokuar kohë të lirë për transmetim për partitë politike dhe deri tani trembëdhjetë parti e kanë shfrytëzuar këtë mundësi. Në plotësim, *MTV-1* i ka plotësuar kërkesat e udhëzimeve nga Këshilli i radiodifuzionit që "të transmetohen

<sup>6</sup> Neni 81 nga Kodi zgjedhor. Kjo praktikë është raportuar nga komunat e Shkupit, pastaj Shtip, Ohër dhe Tetovë.

<sup>7</sup> Mbikqyrur në komunën e Gostivarit dhe Tetovës.

<sup>8</sup> Mbikqyrur në komunat e Krivogashtanit, Dollnenit dhe Drugovës.

<sup>9</sup> Neni 5.4 i OSBE dokumentit të Kopenhagës kërkon një dallim të qartë mes shtetit dhe partive politike; ka pasur disa raste ku ka qenë e vështirë që të dallohet se nëse ministrat të cilët janë kandidatë po veprojnë në rolin e tyre si zyrtarë ose si kandidatë.

<sup>10</sup> Shih Nenin të 75 (5) të Kodit zgjedhor; Ligji për aktivitet transmetues (LAT), Neni 80; dhe Rregullorja për qasje të barabartë në media gjatë fushatës zgjedhore (Rregullore për media), Neni 15.

aktivitetet e të gjitha pjesëmarrësve në procesin zgjedhor" duke krijuar program të posaçëm "Kronika e zgjedhjeve", i cili ka përfshirë transmetim të detajuar të aktiviteteve zgjedhore të garuesve.<sup>11</sup> Megjithatë, edhe koha e lirë për reklamim, edhe "Kronika e zgjedhjeve" janë transmetuar jashtë orarit të shikueshmërisë më të madhe, duke e kufizuar në shumicë publikun e tyre potencial.<sup>12</sup>

*MTV-1* në fillim shpalli se do të transmetojë 14 debate prej 90 minutash në mes garuesve në zgjedhje. Megjithatë, ato informuan se për shkak të problemeve teknike, do ta anulojnë fillimin e debateve. Gjatë periudhës raportuese asnjëra prej katër debateve të parapara nuk është organizuar. Disa kanale televizive private gjithashtu kanë organizuar debate mes partive të ndryshme politike. VMRO ka thënë se nuk do të marrë pjesë në asnjërën prej debateve.

Të dhënat e hershme të vëzhgimit të fushatës mediale nga ana e MVZ të OSBE/ODIHR tregojnë se në kohën kur ka shikueshmëri më të madhe, *MTV-1* e ka favorizuar koalicionin qeverisës të VMRO-DPMNE-së, me lajme politike apo zgjedhore të cilat kanë qenë më së shumti pozitive ose në një ton neutral. Nga ana tjetër, koalicioni i udhëhequr nga opozita e LSDM-ës ka qenë më pak i transmetuar dhe kryesisht në një ton negativ. Lajmet e transmetuara nga *MTV-1* në kohën kur ka shikueshmëri më të madhe, kryesisht në ton pozitiv kanë qenë për aktivitetet e zyrtarëve qeveritarë, përfshirë ato të cilët janë kandidatë. Kjo nuk është në pajtim me detyrat ligjore të *MTVI* si radiodifuzioner publik.<sup>13</sup>

TV kanalet private *Sitel* dhe *Kanal 5* kanë marrë një qasje të ngjajshme me atë të *MTV-1*. Për dallim të tyre, *Televizioni A1*, i cili në fillim të fushatës deklaroi se gjatë zgjedhjeve do ti përkrahë partitë e opozitës, në shumicën e lajmeve i ka kritikuar zyrtarët qeveritar dhe koalicionin të udhëhequr nga VMRO-DPMNE. *Telma* ka përdorur një qasje më të balansuar, edhe pse në përgjithësi është kritike ndaj koalicionit të udhëhequr nga VMRO-DPMNE.

*MTV-2* në gjuhën shqipe dhe televizioni privat *Alsat-M* u kanë përkushtuar më shumë kohë partive etnike shqiptare, mirëpo gjithashtu i kanë transmetuar edhe aktivitetet e koalicioneve kryesore. Raportimi nga *MTV-2* në përgjithësi ka qenë me një ton më pozitiv drejtë qeverisë. Raportimi i *Alsat-M* për garuesit kryesor politik ka qenë kryesisht neutral.

Deri tani, vetëm një numër i vogël i partive gjerësisht e kanë përdorur reklamimin e paguar politik. VMRO-DPMNE është partia e vetme politike e cila reklamohet në *Kanal 5* dhe *Sitel*. Reklamat e LSDM-ës dhe Organizatës së Breshme Revolucionare Maqedonase – Partia Popullore (VMRO-PP) janë paraqitur në *Televizioni A1*, ndërsa reklama nga fushata e Bashkimit Demokratik për Integritim (BDI) dhe Demokracisë së re janë transmetuar në *Alsat-M*, dhe ato të koalicioneve të VMRO-DPMNE dhe LSDM-ës në *TV Telma*. Përderisa të gjitha mediat deri tani e kanë respektuar afatin prej 10 minutave në orë për reklamim të një partie, në një numër të rasteve, një reklamë politike ka zgjatur 20 minuta, duke e përdorur kohën e lejuar për orët pasuese.

## V. ANKESA DHE PARASHTESA

Kurrëfar ankesa zyrtare nuk janë dorëzuar në gjyqe, edhe pse një numër i garuesve politik u janë ankuar VAGJ të MVZ të OSBE/ODIHR lidhur me frikësime, presion mbi nëpunësit shtetëror dhe

<sup>11</sup> Neni 15 nga Rregullorja për media.

<sup>12</sup> Kohë e lirë zakonisht jepet rreth orës 16:00 dhe "Kronika e zgjedhjeve" zakonisht transmetohet pas orës 24:00.

<sup>13</sup> Neni 75 (5) nga Kodi zgjedhor, Neni 80 nga LAT dhe Neni 15 nga Rregullorja për media.

pengim të aktiviteteve të fushatës. Bashkëbiseduesit e MVZ të OSBE/ODIHR e arsyetojnë këtë me mungesën e besimit të cilin e kanë tek organet përgjegjëse.

Më 16 maj, KSHZ i shqyrtoi informatat e marra nga Partia e Drejta Demokratike lidhur me frikësimet e mundshme.<sup>14</sup> KSHZ vendosi se ky rast është jashtë kompetencave të tij dhe të njejtin e referuan tek Prokurori Publik, si autoritet kompetent. Gjithashtu edhe Avokati i popullit e ka inkurajuar Prokurorin publik ta përshpejtojë hetimin e kësaj çështje. Zyra e Prokurorit publik e informoi MVZ të OSBE/ODIHR se hetimi ende është në proces. Në një tjetër rast, më 19 maj Prokurori lokal në Manastirë e rrefuzoi rastin kundër VMRO-DPMNE-së për frikësimet të pohuara mbi nëpunësit shtetëror. Megjithatë duke e pasur parasyshë atë se vetëm dy të punësuar janë marrë në pyetje përpara mbylljes së hetimit, efikasiteti i hetimit mbetet në pyetje.

Më 19 maj, MVZ i OSBE/ODIHR u informua nga LSDM-ja se ato kanë dorëzuar ankesë zyrtare në KSHZ për atë se VMRO-DPMNE ka filluar me fushatë të parakohshme.<sup>15</sup> Në kohën e përgatitjes së këtij raporti, KSHZ-ja ende nuk ka sjellë vendim për këtë ankesë.

Ministria e punëve të brendshme ka raportuar 13 raste të dëmtimit të shtabeve zgjedhore.<sup>16</sup> Janë inicuar hetime, mirëpo asnjëri prej aktorëve ende nuk është identifikuar.

Më 20 maj, zyra e Avokatit të popullit ka hapur linjë falas për raportimin e rasteve të shkeljes së të drejtave të tyre votuese. Gjithashtu do të iniciojë fushatë publike për rritjen e vetëdijes e cila do ti inkurajojë qytetarët që të raportojnë raste të presionit ose frikësimit. Gjashtë avokatë në Zyrën e Avokatit të popullit do ti shqyrtojnë rastet dhe do ti përcejllin të njejtat deri tek institucionet relevante për ti ndërmarrë masat e përshtatshme.

## VI. VËZHgues VENDOR DHE NDËRKOMBËTARË

Kodi zgjedhor lejon që edhe vëzhgues vendor edhe ndërkombëtarë ta vëzhgojnë të gjithë procesin zgjedhor. Të drejtat dhe detyrat e të gjithë vëzhguesve janë dhënë në Kodin për vëzhgim, të miratuar nga KSHZ.<sup>17</sup>

Organizata qytetare MOST planifikon që të pozicionojë 3600 vëzhgues në ditën zgjedhore për të mbuluar rreth 70 përqind të vendotimeve, me rreth 1200 vëzhgues të cilët do të bëjnë numrim paralel të votave në 10 përqind të vendotimeve.

Të dy koalicionet kanë shprehur gatishmërinë e tyre për të pozicionuar përfaqësues të autorizuar për të vëzhguar vendotimet në ditën zgjedhore.

## VII. AKTIVITETET E MVZ TË OSBE/ODIHR

Gjatë periudhës raportuese, MVZ i OSBE/ODIHR vazhdoi me aktivitetet e rregullta, takime me Kryetarin e shtetit, ministra, zyrtarë shtetërorë, përfaqësues partiak dhe kandidatë, administratën zgjedhore, gjyqtarë, përfaqësues të mediva dhe shoqërisë civile, si dhe misione diplomatike. Kryesuesi i MVZ të OSBE/ODIHR, Z. Julian Peel Yates, gjithashtu u takua me Kryesuesin e

<sup>14</sup> *Televizioni A1* raportoi se VMRO-DPMNE u ka dhënë urdhër kryesuesve të sektorëve në institucionet shtetërore të dorëzojnë lista me 15 persona të cilët do ta japin përkrahjen e tyre për këtë parti dhe si shpërblim të fitojnë punësim ose beneficione tjera.

<sup>15</sup> Ato pohojnë se është bërë shkelje e nenit 69-a dhe neni 179-b(1) nga Kodi zgjedhor, të cilat parashohin denim prej 3,000 – 5,000 euro për fillim të fushatës përpara fillimit zyrtarë më 16 maj.

<sup>16</sup> Dritaret e shtabeve zgjedhore të BDI-së, VMRO-DPMNE-së, LSDM-ës dhe të Bashkuar për Maqedoninë janë thyer disa herë në Manastirë, Kavadar, Kërçovë, Kumanovë, Prilep, Shkup dhe Tetovë.

<sup>17</sup> Miratuar më 20 prill, 2011

Asamblesë Parlamentare të OSBE-së dhe Koordinues i Vëzhguesve afatshkurtër të OSBE-së, Z. Robert Battelli dhe me Z. Jean-Charles Gardetto, Kryesues i Delegacionit të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, me rastin e vizitës së tyre parazgjedhore në Shkup.

Informimi i dytë për bashkësinë diplomatike do të mbahet më 30 maj. VAGJ vazhdojnë që të ndjekin përgatitjet zgjedhore dhe fushatën në regjion, si dhe përgatiten për pozicionimin e vëzhguesve afat-shkurtër.